

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU</b>
--	---	--

**SCEL – 10 – 0027**

**Punëtorët e NSH-së XX**

1. G.V.B, XX
  2. M.G., XX
  3. D.S., XX
  4. R.D., XX
  5. B.T., XX
  6. Z.T., XX
  7. D.V.M., XX
  8. M.R., XX
  9. M.M.Ž., XX
  - 10.L.R., XX
  - 11.G.S., XX (njëjtë sikurse C19)
  - 12.J.Z.N., XX
  - 13.B.P., XX
- Përfaqësuar nga avokati XX
- 14.M.M., XX
  - 15.M.V., XX
  - 16.N.V., XX
  - 17.R.S., XX
  - 18.R.M., XX
  - 19.G.Š., XX

*Ankuesit*

*Kundër*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

rr. Ilir Konushevci nr.8, Prishtinë

*I padituri*

Kolegji i Parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit i përbërë nga Gjyqtari Kryesues Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtari Shkelzen Sylaj dhe Gjyqtari Çerim Fazliji, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 10 janar 2013, lëshon këtë

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e G.Š. datë 12 gusht 2011 (C19) hedhet poshtë si e papranueshme.
2. Ankesat e G.V.B. (C1), M.G. (C2), D.S. (C3), R.D. (C4), B.T. (C5), Z.T. (C6), D.V.M. (C7), M.R. (C8), M.M.Ž. (C9), L.R. (C10), G.S. ankesa datë 25 nëntor 2010 (C11), J.Z.N. (C12), B.P. (C13), M.M. (C14), M.V. (C15), N.V. (C16), R.S. (C17), R.M. (C18) janë të bazuara. Këta ankues duhet të përfshihen në Listën përfundimtare të punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së XX.

### Rrethanat faktike dhe procedurale

Ankuesit janë ish punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore NSH-ja XX, Fi nr.618/89 (NSH-ja), e cila kishte 93 punëtorë në kohën kur u privatizua. NSH-ja ishte privatizuar duke krijuar dy Ndërmarrje të Reja:

Ndërmarrja e Re XX e shitur me kontratën e ratifikuar më 06-11-2006 dhe Ndërmarrja e Re XX e shitur në valën 41 të privatizimit me kontratën e ratifikuar më 02-12-2009.

Lista e përkohshme e punëtorëve me të drejta legjitime që i përmbante 40 punëtorë ishte publikuar më 18 korrik 2009.

Lista përfundimtare (faqja 50 e dosjes gjyqësore), që përmban 48 persona, 40 me emra shqiptarë dhe 8 me emra serbë, ishte publikuar më 10, 11, 12 dhe 13 nëntor 2010. Afati për ankesa kundër listës përfundimtare ishte vendosur 4 dhjetori 2010. Ankuesit nuk ishin pranuar në listë. Ata të gjithë mendojnë se i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20% prej të hyrave nga shitja.

Më 25 nëntor 2010, G.V.B. (**ankuesja C1**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej “AKP”) ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20% prej të hyrave nga privatizimi i NSH-së që është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010. Ankuesja ka punuar në NSH nga data 10 shtator 1990 deri në qershor të vitit 1999. Ajo theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën.

Ajo ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ajo e dorëzoi kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesja nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesja nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Në përgjigjen e datës 31 korrik 2012 ankuesja deklaroi se interpretimi i ligjit i dorëzuar nga AKP-ja është i gabuar. Ajo thekson se në publikimin e listës përfundimtare në numrin e Blicit të datës 11 nëntor 2010 AKP-ja ka njoftuar se secili punëtor i cili mendon se ka të drejtë të përfshihet në listë dhe që i kundërshton emrat në listë mund të parashtojë ankesë në Dhomën e Posaçme dhe nuk kishte ndonjë indikacion se kjo ka të bëjë vetëm me ata që kanë kontestuar listën e përkohshme. Më tej ajo thekson se neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 nuk përcakton se vetëm ata ankues që parashtojnë ankesë kundër listës së përkohshme kanë të drejtë të parashtojnë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve.

Më 25 nëntor 2010, M.G. (**ankuesi C2**) parashtoi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 10 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 11 korrik 1987 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai e dorëzoi kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 25 nëntor 2010, D.S. (**ankuesi C3**) parashtoi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010.

Ankuesi ka punuar në NSH nga data 23 gusht 1995 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai tha se librezja e tij e punës ka mbetur në NSH dhe e ka dorëzuar kopjen e librezës shëndetësore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 25 nëntor 2010, R.D. (**ankuesi C4**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 20 korrik 1987 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Në përgjigjen e datës 2 gusht 2012 ankuesi deklaroi se interpretimi i ligjit i dorëzuar nga AKP-ja është i gabuar. Ai thekson se në publikimin e listës përfundimtare në numrin e Blicit të datës 11 nëntor 2010 AKP-ja ka njoftuar se secili punëtor i cili mendon se ka të drejtë të përfshihet në listë dhe që i kundërshton emrat në listë mund të parashtojë ankesë në Dhomën e Posaçme dhe nuk kishte ndonjë indikacion se kjo ka të bëjë vetëm me ata që kanë kontestuar listën e përkohshme. Më tej ai thekson se neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 nuk përcakton se vetëm ata ankues që parashtrojnë ankesë kundër listës së përkohshme kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve.

Më 25 nëntor 2010, B.T. (**ankuesi C5**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 17 dhjetor 1982 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t’i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 25 nëntor 2010, Z.T. (**ankuesi C6**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 15 dhjetor 1993 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së sigurimit shëndetësor.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka paraqitur prova për punësimin e tij në NSH në kohën e privatizimit, se i plotëson kërkesat ligjore për të qenë në listë, dhe për të provuar pretendimet e tij si ishte diskriminuar.

Më 25 nëntor 2010, D.V.M. (**ankuesi C7**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 26 shtator 1983 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së punës dhe të vendimit mbi punësimin.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Në përgjigjen e datës 26 korrik 2012 ankuesi deklaroi se interpretimi i ligjit i dorëzuar nga AKP-ja është i gabuar. Ai thekson se në publikimin e listës përfundimtare në numrin e Blicit të datës 11 nëntor 2010 AKP-ja ka njoftuar se secili punëtor i cili mendon se ka të drejtë të përfshihet në listë dhe që i kundërshton emrat në listë mund të parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme dhe nuk kishte ndonjë indikacion se kjo ka të bëjë vetëm me ata që kanë kontestuar listën e përkohshme. Më tej ai thekson se neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 nuk përcakton se vetëm ata ankues që parashtrorë ankesë kundër listës së përkohshme kanë të drejtë të parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve.

Më 25 nëntor 2010, M.R. (**ankuesi C8**) parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në "Blic" më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 22 maj 1996 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së punës dhe të librezës së sigurimit shëndetësor.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 25 nëntor 2010, M.M.Ž. (**ankuesja C9**) parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në "Blic" më 11 nëntor 2010. Ankuesja ka punuar në NSH nga data 21 tetor 1992 deri në qershor të

vitit 1999. Ajo theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ajo ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ajo ka dorëzuar kopjen e librezës së punës dhe të vendimit të NSH-së për pushimin vjetor.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesja nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesja nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Në përgjigjen e datës 31 korrik 2012 ankuesja deklaroi se interpretimi i ligjit i dorëzuar nga AKP-ja është i gabuar. Ajo thekson se në publikimin e listës përfundimtare në numrin e Blicit të datës 11 nëntor 2010 AKP-ja ka njoftuar se secili punëtor i cili mendon se ka të drejtë të përfshihet në listë dhe që i kundërshton emrat në listë mund të parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme dhe nuk kishte ndonjë indikacion se kjo ka të bëjë vetëm me ata që kanë kontestuar listën e përkohshme. Më tej ajo thekson se neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 nuk përcakton se vetëm ata ankues që parashtrorë ankesë kundër listës së përkohshme kanë të drejtë të parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve.

Më 25 nëntor 2010, L.R. (**ankuesi C10**) parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në "Blic" më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga viti 1988 deri në qershor të vitit 1999. Ai theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së sigurimit shëndetësor.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 25 nëntor 2010, G.S. (**ankuesja C11 dhe C19**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010. Ankuesja ka punuar në NSH nga viti 1987 deri në qershor të vitit 1999. Ajo theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas qershorit të vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ajo ankohet se ishte diskriminuar sepse i takon etnisë serbe. Ajo ka dorëzuar kopjen e librezës së sigurimit shëndetësor.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesja nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesja nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t’i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Në përgjigjen e datës 1 gusht 2012 ankuesja deklaroi se e ka humbur afatin për të kundërshtuar listën e përkohshme sepse kishte probleme shëndetësore dhe ajo e parashtroi ankesën posa ishte në gjendje t’a bënte një gjë të tillë. Ankuesja ofron një adresë në Kosovë. Ankuesja më tej thekson se ka parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme më 19 nëntor 2010 përmes një OJQ-je, dhe prandaj ankesa e saj ishte në kohë.

Më 25 nëntor 2010, J.Z.N. (**ankuesi C12**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Koha Ditore” më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH që nga viti 1999 dhe prandaj ai thekson se i ka plotësuar kërkesat ligjore për të qenë në listë. Ankuesi ka dorëzuar një kopje të listës së pagave të NSH-së për 3 vitet e fundit para privatizimit.

Në vërejtjet me shkrim të datës 8 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t’i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 26 nëntor 2010, B.P. (**ankuesi C13**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga



privatizimi i NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 5 korrik 1985 deri më 9 qershor 1999. Ai theksoi se NSH-ja ishte privatizuar në vitin 1999 me 93 punëtorë. Ai theksoi se i plotëson të gjitha kërkesat por nuk ishte trajtuar në mënyrë të barabartë. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së sigurimit shëndetësor.

Në vërejtjet me shkrim të datës 16 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t'i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Më 1 dhjetor 2010, M.M. (**ankuesi C14**) parashtrroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH për 13 vite nga data 25 tetor 1986 deri më 17 qershor 1999 dhe librezja e tij e punës nuk është mbyllur në NSH. Ai theksoi se gjysma e punëtorëve në listën e përkohshme të publikuar nga AKP-ja nuk kanë punuar në NSH para vitit 1999. Ankesa e tij kundër Listës së Përkohshme ishte refuzuar nga AKP-ja mbi bazën se marrëdhënia e tij e punës nuk kishte vazhduar pas vitit 1999, ai nuk ishte përpjekur të kthehej në punë dhe kopja e librezës së tij të punës nuk ishte vërtetuar. Ankuesi e kundërshton një vendim të tillë si të pabazuar dhe shpjegon se ai u përpoq të kthehej në punë kur u kthye në Kosovë por fabrika nuk funksiononte më. Ankuesi thekson se ai i plotëson të gjitha kërkesat dhe ai ishte diskriminuar. Ankuesi ka dorëzuar kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 16 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk i plotëson kërkesat ligjore për të qenë në listë. AKP-ja thekson se ankuesi nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme se ka qenë i punësuar në NSH pas qershorit të vitit 1999, se ishte diskriminuar dhe se kishte kërkuar siguri nga KFOR-i apo Policia e UNMIK-ut pas vitit 1999.

Në përgjigjen e datës 26 korrik 2012 ankuesi deklaroi se ai kishte punuar në NSH deri më 17.06.1999 kur u detyrua të largohej nga Kosova për shkak të gjendjes së njohur të sigurisë. Ai thekson se ankesa e tij ishte parashtruar më 1 dhjetor 2010 dhe prandaj ishte brenda afatit.

Më 1 dhjetor 2010, M.V. (**ankuesja C15**) parashtrroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të

cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Ankuesja ka punuar në NSH për 17 vite nga data 19 gusht 1981 deri më 17 qershor 1999. Ajo theksoi se është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën dhe qëndroi në Serbi si person i zhvendosur. Ajo theksoi se gjysma e punëtorëve në listën e përkohshme të publikuar nga AKP-ja nuk kanë punuar në NSH para vitit 1999. Ankesa e saj kundër Listës së Përkohshme ishte refuzuar nga AKP-ja mbi bazën se marrëdhënia e saj e punës nuk kishte vazhduar pas vitit 1999, ajo nuk ishte përpjekur të kthehej në punë dhe kopja e librezës së saj të punës nuk ishte vërtetuar. Ankuesja e kundërshton një vendim të tillë si të pabazuar dhe shpjegon se ajo u përpoq të kthehej në punë kur u kthye në Kosovë por fabrika nuk funksiononte më. Ankuesja thekson se ajo i plotëson të gjitha kërkesat dhe ajo ishte diskriminuar. Ankuesja ka dorëzuar kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 16 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesja nuk i plotëson kërkesat ligjore për të qenë në listë. AKP-ja thekson se ankuesja nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme se ka qenë e punësuar në NSH pas qershorit të vitit 1999, se ishte diskriminuar dhe se kishte kërkuar siguri nga KFOR-i apo Policia e UNMIK-ut pas vitit 1999.

Në përgjigjen e datës 26 korrik 2012 ankuesja deklaroi se ajo kishte punuar në NSH deri më 19.06.1999 kur u detyrua të largohej nga Kosova për shkak të gjendjes së njohur të sigurisë. Ajo thekson se ankesa e saj ishte parashtruar më 1 dhjetor 2010 dhe prandaj ishte brenda afatit.

Më 1 dhjetor 2010, N.V. (**ankuesi C16**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH për 17 vite nga data 15 dhjetor 1993 deri më 17 qershor 1999. Ai theksoi se është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën dhe qëndroi në Serbi si person i zhvendosur. Ai ishte punësuar përkohësisht në periudhën 2009-2010 pasi që fabrika ishte privatizuar. Ai theksoi se gjysma e punëtorëve në listën e përkohshme të publikuar nga AKP-ja nuk kanë punuar në NSH para vitit 1999. Ankesa e tij kundër Listës së Përkohshme ishte refuzuar nga AKP-ja mbi bazën se marrëdhënia e saj e punës nuk kishte vazhduar pas vitit 1999, ai nuk ishte përpjekur të kthehej në punë dhe kopja e librezës së tij të punës nuk ishte vërtetuar. Ankuesi e kundërshton një vendim të tillë si të pabazuar dhe shpjegon se ai u përpoq të kthehej në punë kur u kthye në Kosovë por fabrika nuk funksiononte më. Ankuesi thekson se ai i plotëson të gjitha kërkesat dhe

ai ishte diskriminuar. Ai thekson se është në pozitë të njëjtë sikurse këta persona në listë: R.C., R.B., M.Š., O.V., Ž.S. dhe Z.A. të cilët u larguan nga Kosova në vitin 1999, kanë statusin e personave të zhvendosur dhe nuk janë kthyer në Kosovë. Ai kërkon që të njëjtat kritere të aplikohen edhe për të. Ankuesi ka dorëzuar kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 16 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk i plotëson kërkesat ligjore për të qenë në listë. AKP-ja thekson se ankuesi nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme se marrëdhënia e tij e punës me NSH-në ka vazhduar pas qershorit të vitit 1999 dhe për të provuar pretendimet e tij si ishte diskriminuar. AKP-ja paraqet se ankuesi nuk kishte ofruar prova se ai kishte kërkuar siguri nga KFOR-i apo Policia e UNMIK-ut pas vitit 1999.

Në përgjigjen e datës 26 korrik 2012 ankuesi deklaroi se ai kishte punuar në NSH deri më 17.06.1999 kur u detyrua të largohet nga Kosova për shkak të gjendjes së njohur të sigurisë. Ai thekson se ankesa e tij ishte parashtruar më 1 dhjetor 2010 dhe prandaj ishte brenda afatit.

Më 25 nëntor 2010, R.S. (**ankuesi C17**) parashtrroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoji përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar në “Blic” më 11 nëntor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga data 1 gusht 1990 deri në vitin 1999. Ankuesi theksoi se nuk mund të shkonte në punë pas vitit 1999 sepse është detyruar të largohet nga Klina për shkak të situatës me rrezik për jetën. Ai thekson se i plotëson të gjitha kërkesat por ai ishte diskriminuar për shkak të etnisë së tij serbe. Ai ka dorëzuar kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 17 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se për këtë ankuesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet administrative të ankimit para se t’i drejtohet gjykatës siç kërkohet me nenin 127.4 të Ligjit nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative.

Në përgjigjen e datës 7 gusht 2012 ankuesi deklaroi se interpretimi i ligjit i dorëzuar nga AKP-ja është i gabuar. Ai thekson se në publikimin e listës përfundimtare në numrin e Blicit të datës 11 nëntor 2010 AKP-ja ka njoftuar se secili punëtor i cili mendon se ka të drejtë të përfshihet në listë dhe që i kundërshton emrat në listë mund të parashtrtojë ankesë në Dhomën e Posaçme dhe nuk kishte ndonjë indikacion se kjo ka të bëjë

vetëm me ata që kanë kontestuar listën e përkohshme. Më tej ai thekson se neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 nuk përcakton se vetëm ata ankues që parashtrajnë ankesë kundër listës së përkohshme kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve.

Më 2 dhjetor 2010, R.M. (**ankuesi C18**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së siç është publikuar më 11 nëntor 2010 në Koha Ditore dhe Blic. Ankuesi ka punuar në NSH nga data viti 1991 deri në vitin 1999 kur u detyra të lë punën kundër vullnetit të tij. Ankuesi thekson se ai është në të njëjtën situatë sikurse ish kolegët e tij të cilët punuan bashkë me të gjatë të njëjtës periudhë kohore: R.C., R.B., G.B., R.B. dhe M.Š. Ankuesi ka dorëzuar kopjen e librezës së punës dhe të sigurimit pensional të vitit 1991.

Në vërejtjet me shkrim të datës 17 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk ka plotësuar kërkesat ligjore për të qenë në listë pasi që ai nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit. AKP-ja thekson se ankuesi nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme se marrëdhënia e tij e punës me NSH-në ka vazhduar pas qershorit të vitit 1999 dhe për të provuar pretendimet e tij se ai ishte diskriminuar. AKP-ja paraqet se ankuesi nuk ofroi prova se kishte kërkuar siguri nga KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut pas vitit 1999.

Më 12 gusht 2011, G.Š. (**ankuesja C19 dhe C11**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së ku kërkoi përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Ankuesja thekson se ka punuar në NSH nga data 25 nëntor 1985, ajo i plotëson kushtet për të qenë në listë dhe ajo ishte diskriminuar. Ajo theksoi se vite më parë kishte parashtruar në Agjenci një kërkesë për përfshirje në listë por asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje. Ankuesja ka paraqitur kopjen e librezës së sigurimit shëndetësor, të listës së punëtorëve të vitit 1989.

Në vërejtjet me shkrim të datës 15 shtator 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse afati i fundit për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme ishte data 4 dhjetor 2010.

### **Arsyetimi ligjor**

1. Ankesa e G.Š. (ankuesja C19) është e papranueshme.

Sipas nenit 67.6 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr 2008/6 në lidhje me nenin 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr 2003/13, ankesa kundër Listës Përfundimtare duhet të dorëzohet brenda 20 ditëve pas publikimit të Listës Përfundimtare. Publikimi ishte bërë më 10, 11, 12 dhe 13 nëntor 2010. Ankesa ishte dorëzuar më 12/8/2011. Kjo ankesë duhet të hedhet poshtë edhe në bazë të nenit 391 (c) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore sepse ankuesja veçse kishte parashtruar ankesë më parë (e regjistruar me C11). Ankesa e parë është pranuar si e pranueshme dhe e bazuar.

2. Ankesat e ankuesve

G.V.B. (C1), M.G. (C2), D.S. (C3), R.D. (C4), B.T. (C5), Z.T. (C6), D.V.M. (C7), M.R. (C8), M.M.Ž. (C9), L.R. (C10), G.S. (C11), J.Z.N. (C12), B.P. (C13), M.M. (C14), M.V. (C15), N.V. (C16), R.S. (C17), R.M. (C18) janë të pranueshme.

Ato janë dorëzuar brenda afatit të dhënë me nenin 67.6 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr 2008/6 në lidhje me nenin 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Moskundërshtimi i listës së përkohshme nga Ankuesit sipas nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 nuk e bën të papranueshme padinë kundër Listës Përfundimtare.

a. Neni 127 i Ligjit Nr 02/L-28 mbi Procedurën Administrative nuk zbatohet. Neni 127 thotë

*“Ankimi administrativ*

*127.1. Ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës.*

*127.2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ.*

*127.3. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.*

*127.4. Palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit.”*

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 në nenin 70.3 (a) dhe (b) nën titullin Ligji në Fuqi nuk i referohet Ligjit Nr 02/L-28 mbi

Procedurën Administrative por i referohet Ligjit mbi Procedurën Kontestimore i cili nuk përmban ndonjë dispozitë që kërkon shterimin e të gjitha mjeteve administrative para drejtimit në gjykatë.

Por edhe nëse do të zbatohet neni 127 i Ligjit Nr 02/L-28 mbi Procedurën Administrative, Ankuesit nuk do të kishin pasur nevojë të kundërshtonin Listën e Përkohshme para se të ankoheshin kundër listës përfundimtare. Padia e tyre nuk ka të bëjë me Listën e Përkohshme (e cila mund të ishte kundërshtuar) por me Listën Përfundimtare (kundër të cilës nuk është i mundur asnjë mjet administrativ).

- b. Edhe formulimi i nenit 67.2, fjalia e parë, Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që punëtori duhet të kundërshtojë Listën e Përkohshme në mënyrë që të ketë të drejtë më vonë të ankohet kundër Listës Përfundimtare. Neni 67.2, fjalia e parë, Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 thotë:

*“Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtojë ankesë në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.”*

Ligji e thotë vetëm të drejtën për ta kundërshtuar listën e përkohshme, por nuk thotë se kush nuk e kundërshton listën e përkohshme nuk mundet më vonë ta kundërshtojë listën përfundimtare.

- c. Kolegji është në dijeni, se obligimi për të kundërshtuar çfarëdo mangësie në listën e përkohshme i kombinuar me sanksionimin se nëse kjo nuk bëhet, ankesa kundër listës përfundimtare bëhet e papranueshme do t'a ndihmonte Agjencinë që, në një kohë më të shkurtër, të krijonte listën përfundimtare të korrigjuar.

Obligimi për të shteruar mjetet administrative para adresimit në gjykatë do t'a pengonte palën në shfrytëzimin e mjeteve gjyqësore pa nevojë.

Procedura që në fillim të krijohet Lista e Përkohshme dhe t'u jepet mundësia të gjithëve që të kundërshtojnë këtë listë dhe të dorëzojnë faktet dhe provat brenda 20 ditëve do ta ndihmojë AKP-në të krijojë Listën e korrigjuar Përfundimtare pa vonesa të panevojshme. Ajo ka për qëllim që

të përqendrohet dhe të shpejtojë procedurën. Mbledhja sa më e hershme e të gjitha fakteve të dhe provave të nevojshme është një aset themelor në kontekstin procedural në të cilën shumica monetare e pjesës së 20% për çdo punëtor varet në vendimin mbi pranimin apo refuzimin e ankesave të parashtruara.

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk lejon që të sanksionohet mungesa e bashkëpunimit të Punëtorit në fazën e krijimit të Listës Përfundimtare duke e bërë ankesën kundër Listës Përfundimtare të papranueshme (ngjashëm: Aktgjykimi SCEL-09-0001 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme).

### 3. Ankesat e ankuesve

G.V.B. (C1), M.G. (C2), D.S. (C3), R.D. (C4), B.T. (C5), Z.T. (C6), D.V.M. (C7), M.R. (C8), M.M.Ž. (C9), L.R. (C10), S.G. (C11), J.Z.N. (C12), B.P. (C13), M.M. (C14), M.V. (C15), N.V. (C16), R.S. (C17), R.M. (C18) janë të pranueshme dhe të bazuara.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, i parashikon kërkesat që një punëtor të konsiderohet legjitim dhe neni 10 e paraqet procedurën për parashtrimin e ankesës në Dhomën e Posaçme si vijon:

*“10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6..”*

### 10.6

. ....

*(b) Çfarëdo ankese e dorëzuar në Dhomën e Posaçme me bazë diskriminimin si shkak për mospërfshirjen në listën e të punësuarve me të drejta legjitime, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara për diskriminimin e pretenduar;.”*

Të gjithë këta ankues, asnjëherë nuk janë larguar më parë nga NSH-ja por as nuk kanë qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit. Ata të gjithë janë larguar nga NSH-ja dhe Klina në qershor të vitit 1999 apo pas qershorit të vitit 1999 sepse nuk janë ndier të sigurt më. Asnjëri prej tyre nuk ka dorëzuar dokumente që tregojnë se ai/ajo faktikisht është sulmuar

apo diskriminuar. Asnjëri prej tyre nuk ka pretenduar në detaje ndonjë veprim të agresionit apo diskriminimit. Por as i padituri nuk e ka kontestuar se ata janë larguar nga vendi i tyre nga frika dhe nuk ka e kontestuar se një frikë e tillë pas përfundimit të luftës në Klinë ishte arsyetuar për qytetarët e etnisë serbe. Në një procedurë kontestimore për këtë kjo mund të merret si fakt mbi të cilin mund të bazohet vendimi dhe për të cilat nuk ka nevojë për dokumente apo prova tjera.

Por edhe nëse i padituri do të kontestonte që ankuesit kanë ikur nga Klina nga frika e arsyetuar e dhunës dhe diskriminimit gjykata do të duhej t'a aprovonte padinë.

Nuk janë ankuesit por i padituri ai që duhet të dëshmojë diskriminimin. Barra e provës, e cila sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 duhet të bartej nga ankuesit ka kaluar tek i padituri me Ligjin Nr 2004/3 Kundër Diskriminimit (Rregullorja e UNMIK-ut 2004/32).

Neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, mbi barrën e provave, thotë si vijon:

*“8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.*

*8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.”*

Neni 11 i të njëjtit ligj thotë:

*“11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.*

*11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji.”*

Përfundimi i luftës në mes të qytetarëve të etnisë shqiptarë dhe qytetarëve të etnisë serbe, dhuna dhe diskriminimi kundër qytetarëve shqiptarë para dhe gjatë luftës dhe tërheqja e forcave ushtarake serbe kur përfundoi lufta ishin që të gjitha fakte të cilat bëjnë të mundur supozimin se mund të kishte ndodhur diskriminimi kundër



minoritetit serb të mbetur. Prandaj do të kishte mbetur barrë për të paditurin që të dëshmojë se nuk kishte diskriminim, e jo barrë për ankuesit se kishte diskriminim (neni 8.1 i Ligjit Kundër Diskriminimit, ngjashëm me Aktgjykimin SCEL-09-0001 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme). Pasi që këta ankues të cilët të gjithë kishin punuar më shumë se tre vite në NSH u detyruan t'a lënë vendin e tyre të punës në vitin 1999 për arsye të etnisë ata duhet të konsiderohen sikurse janë të punësuar, të regjistruar dhe në listë të pagave në kohën e privatizimit. Prandaj, padia e tyre është e bazuar (neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13).

### **Shpenzimet gjyqësore**

Gjykata nuk cakton shpenzime për Ankuesit pasi që Presidiumi i gjykatës deri më tani nuk ka lëshuar ndonjë plan me shkrim i cili është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (neni 57, paragrafi 2, i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka bazë ligjore për të ngarkuar shpenzime.

### **Këshillë ligjore**

Kundër këtij Aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'u dërgohet edhe palëve tjera dhe tek Trupi Gjyqësor nga apeluesi brenda 21 ditësh. Apeluesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar apelin tek palët tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur apeluesit i është dërguar Aktgjykimi me shkrim.

### **Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të papranueshme nëse apeluesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.**

I Padituri mund të parashtrrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dërguar përgjigjen edhe tek apeluesi dhe tek palët tjera.

Apeluesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek apeluesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk  
Gjyqtar Kryesues